



09



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

VROJTIM “MBI DISA ASPEKTE TË KLIMËS SË INVESTIMEVE”

Tiranë, Nëntor 2017

Ky dokument pune është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve në kuadër të mbledhjes XI të Këshillit të Investimeve (6 dhjetor 2017), znj. Ermelinda Xhaja, eksperte për ekonominë dhe z. Elvis Zerva, ekspert ligjor, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni). Mbështetje është ofruar nga znj. Elisa Lula, oficere administrative dhe komunikimit e Sekretariatit në organizimin e takimeve me partnerë, mbarëvajtjen & promovimin e anketës, si dhe redaktimin gjuhësor të materialit. Falenderojmë për kontributin në hartimin e pyetësorit, procesin e konsultimit dhe finalizimin e materialit, z. Artur Papajani, znj. Mimoza Kalia, znj. Silvana Meko, dhomat e tregtisë dhe subjektet private. Një falenderim i veçantë për Universitetin Epoka për bashkëpunimin në kuadër të testimit të rezultateve sasiore të pyetësorit, si edhe studentet për kontributin në promovimin e anketës dhe përditësimin e të dhënave.

LISTA E SHKURTIMEVE

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AT	Administratë Tatimore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
DAT	Drejtoria e Apelimit Tatimor
OPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
KI	Këshilli i Investimeve
MF	Ministria e Financave
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
KONTEKSTI	7
METODOLOGJIA E VROJTIMIT	10
GJETJET E VROJTIMIT	12
1. Mbi Kontrollin Tatimor	12
2. Mbi Rimbursimin e TVSH-së	14
3. Mbi Marrëdhëniet me Administratën Tatimore	16
4. Mbi Informalitetin	17
5. Çështje të tjera mbi klimën e investimeve	19
REKOMANDIME TË KI 2015-2016	20
KONKLUSIONE	22
SHTOJCA 1. KOMENTE NGA BIZNESI	23
SHTOJCA 2. PYETËSORI	25
SHTOJCA 3. STATUSI I REKOMANDIMEVE	32

HYRJE

Që nga krijimi në prill 2015, Këshilli i Investimeve (KI) ka trajtuar një sërë problematikash të klimës së biznesit për të cilat janë lënë dhe rekomandime konkrete për Qeverinë. Një pjesë e këtyre problematikave janë evidentuar si nga konsultimet direkte, ashtu edhe nëpërmjet anketimeve online që ka kryer Sekretariati i Këshillit të Investimeve. Një nga sugjerimet e anëtarëve të KI-së ka qenë monitorimi i çështjeve të trajtuara më parë për të evidentuar ndryshimet dhe kahun e tyre në perceptimet dhe eksperiencat e biznesit. Në këtë kontekst, objekt i këtij vrojtimi mbi disa aspekte të klimës së investimeve, ka qenë evidentimi i ecursisë së shqetësimeve kryesore të biznesit mbi: i) Inspektimin Tatimor dhe Marrëdhëniet me Administratën Tatimore; ii) Rimbursimin e TVSH-së; dhe iii) Informalitetin. Të tre tematikat janë trajtuar gjatë 2015 – 2016 në mbledhje të veçanta të KI duke ofruar dhe rekomandime konkrete për institucionet përkatëse.

Një seksion i veçantë, në formën e një pyetje të hapur, është lënë në vërtetim për bizneset për t'u shprehur mbi problematika në tërësi të klimës së investimeve që ndeshin gjatë aktivitetit të tyre apo dhe në sektorin ku operojnë. Gjithashtu, synimi i Sekretariatit ka qenë që në disa nga gjetjet kryesore të mundësojë krahasim me

rezultatet e sjella në vërtetimet e 2015-2016, për këto tematika konkrete.

Ky vërtetim nuk tenton të jetë gjithëpërfshirës dhe përgjithësues në gjetjet e veta për komunitetin e biznesit, por të sjellë në mënyrë të strukturuar perceptimet dhe eksperiencat e tashmë 146 bizneseve që janë përgjigjur në mënyrë rastësore dhe anonime në vërtetim.

Gjatë gjithë procesit të hartimit dhe kryerjes së vërtetimit, Sekretariati është konsultuar me ekspertë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), si edhe me përfaqësues të Universitetit Epoka. Rezultatet sasiore të pyetësorit janë testuar për besueshmërinë e tyre me metoda statistikore nga ekspertë të Universitetit Epoka.

Gjetjet e këtij vërtetimi të përshkruara në seksionin 4 do shërbejnë për të orientuar diskutimet dhe ofruar sugjerime konkrete në vijim për KI mbi problematikat që mbeten ende të ndjeshme për bizneset. Disa nga **mesazhet kryesore** që kanë dalë nga vërtetimi janë përmbledhur më poshtë:

» Rritje e lehtë e numrit të kontrolleve, kryesisht tek bizneset mbi 8 milion ALL xhiro vjetore, e evidentuar më tepër nga raportimet në formën e *vizitave fiskale* dhe *vizita në terren* se sa kontrole të plota dhe veçanërisht në sektorët e tregtisë dhe shërbimeve.

- » Përmirësim i *perceptimit mbi profesionalizmin e inspektorit tatimor*, veçanërisht në drejtim të komunikimit, sjelljes dhe etikës ndaj biznesit. Megjithatë ende biznesi percepton se ka nevojë për investime dhe ngritje kapacitetesh profesionale të inspektorëve në administratën tatimore për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të tij.
- » Rritje të *dukshme* të vlerësimit në tërësi të *cilësisë së raportit të kontrollit*, megjithatë ka akoma probleme të raportuara sidomos në lidhje me përmbajtjen e raportit dhe gjetjet/përfundimet e tij.
- » Përmirësim i respektimit të afateve të rimbursimit në 2017 sidomos për eksportuesit mbi 70%, ku është rritur ndjeshëm numri i raportimeve për rimbursime brenda 60 ditëve dhe rimbursimi automatik, por akoma raportohen raste që rimbursohen përtej 90 ditëve.
- » Evidentohet një përmirësim i dukshëm në drejtim të transparencës dhe komunikimit me biznesin nëpërmjet aksesit në kohë reale në shërbimet *e-tax* dhe informacionit të ofruar nga administrata tatimore, ashtu si dhe të dijenisë mbi zbatimin e përzgjedhjes

- me sistem risku për kontroll. Është shumë i rëndësishëm vazhdimi i procesit të dixhitalizimit të shërbimeve ndaj tatimpaguesve.
- » Mbetet sfida edukimi në *vazhdimësi* i tatimpaguesve për dinamikën e legjislacionit fiskal, por dhe rritja e profesionalizimit të administratës tatimore në përgjigjet me “specifikë” për sqarim të tatimpaguesve.
- » Ka një perceptim në rënie nga bizneset mbi masën e *“fenomenit informalitet”* në krahasim me vitin 2015, ndërkohë që pragu i tatimit/TVSH, marrëdhënia me administratën dhe zbatueshmëria e ligjit mbeten faktorët kryesorë të raportuar që mund të nxisin informalitetin.
- » Reduktimi i burokracive administrative, rritja e profesionalizimit të administratës, por dhe incentiva për bizneset e ndershme dhe që investojnë janë disa nga kërkesat kryesore të biznesit për të nxitur formalizimin e shpejtë të ekonomisë.

Në seksionin e fundit të Notës Teknike paraqiten rekomandimet e KI të dhëna në mbledhjet përkatëse mbi çështjet që prek vërtetimin, të cilat ngelen akoma aktuale për t'u marrë përsipër dhe zbatuar nga Qeveria Shqiptare.

KONTEKSTI

Sektori privat në Shqipëri ka një kontribut shumë thelbësor në ekonominë shqiptare si në PBB dhe në punësim (rreth 85% të punësuarve), referuar të dhënave të INSTAT. Sipërmarrja shqiptare është e organizuar në shumicën absolute të saj (95%)¹ në formën e bizneseve të vogla dhe të mesme me 1-9 të punësuar. Gjatë periudhës së tranzicionit, biznesi shqiptar ka vuajtur një ngërç në marrëdhëniet dhe komunikimin me administratën në tërësi dhe në veçanti me atë tatimore dhe doganore, për arsye që lidhen si me kapacitetet e administratës publike, qartësinë dhe stabilitetin e legjislacionit, mangësitë në informim ashtu dhe me pjekurinë e biznesit vendas për t'iu përshatur detyrimeve ligjore.

Sekretariati i KI që prej prill 2015 ka ndjekur në mënyrë të veçantë problematika që lidhen me *Kontrollin Tatimor*, *Informalitetin*, *Ankimin Administrativ*, *Rimbursimin e TVSH-së*, *Procedurat Doganore*, etj., të cilat janë trajtuar dhe në mbledhje të veçanta të KI. Për qëllime të analizës për tematikat e trajtuara, Sekretariati përveç konsultimit direkt me biznese dhe shoqata, ka zhvilluar disa vërtetime online, ndër të tjera për:

1. *Kontrollin Tatimor* – Vërtetimi i kryer gjatë gusht – shtator 2015 dhe plotësuar në mënyrë rastësore online nga 110 biznese, ku 78% biznese me xhiro vjetore mbi 8 milion ALL, sektorë përfaqësues: shërbime, (56%), industri, (19%) dhe tregti (17%).
2. *Informalitetin* – Vërtetimi i kryer gjatë tetor – nëntor 2015, plotësuar online në mënyrë rastësore nga 89 biznese, ku 57% janë biznese me xhiro vjetore mbi 8 milion ALL dhe nga tregtia (35%), industri (24%) dhe shërbime (23%).
3. *Rimbursimin e TVSH-së* – Vërtetimi i kryer gjatë shtator – tetor 2016, plotësuar nga 77 biznese në mënyrë rastësore online, 85% biznese me xhiro vjetore mbi 8 milion ALL, kryesisht nga industria përpunuese (31%), tregti (25%), energji e gaz (10%), shërbime (24%).

Disa nga gjetjet kryesore të këtyre vërtetimeve mbi problematikat kryesore (2015-2016) të evidentuara kanë qenë:

- » *Numri i lartë i kontroleve për biznesin* e madh dhe koha e zgjatur e kontroleve nga 1 – 4 javë duke krijuar kosto në kohë dhe burime njerëzore sidomos për këtë kategori biznesi.
- » *Vlerësim i ulët për kapacitetet e inspektorit tatimor*, qartësinë e raportit të kontrollit dhe

¹ INSTAT, Anketa e Ndërmarrjeve, 2016

informacionit të ofruar nga administrata tatimore ndaj biznesit.

- » Shumica e të anketuarve konfirmonin *konkurrencën e pandershme si rezultat i informalitetit dhe faktin se shfaqej kryesisht në formën e shmangies* së taksave, korrupsionit dhe kontrabandës, mosregjistrimit të biznesit apo punës në të zezë.
- » Bizneset janë shprehur *të ndërgjegjshme për kostot* që mbart të qënit informal dhe kërkojnë një politikë më tepër incentivuese për formalizim sesa ndëshkuese. Sipas biznesit, shkaqet kryesore që nxisin informalitetin në ekonomi, lidhen me korrupsionin apo ndikimi politik në biznese, kapacitetet e administratës tatimore dhe doganore apo fragmentizimi i sistemit tatimor.
- » *Respektimi i afatit brenda* 30 ditëve, në kuadrin e rimbursimit të TVSH-së, sidomos për eksportuesit mbi 70%, ka qenë shumë i ulët në numër dhe rimbursimi ishte marrë në shumicën e rasteve, pas kontrollit nga administrata tatimore.
- » Bizneset eksportuese e vlerësonin si të rëndësishëm procesin e rimbursimit në vendimin e tyre për të investuar.

Në lidhje me tre temat e mësipërme, Këshilli i Investimeve ka dhënë në total 38 rekomandime. Në dy vitet e fundit ka patur një qëndrim proaktiv nga ana e Ministrisë së Financave për të transpozuar në masa konkrete, me qëllim lehtësimin e procedurave tatimore, disa nga rekomandimet e biznesit të ngritura edhe nëpërmjet KI. Në Shtojcën 4, jepet në mënyrë të detajuar një përmbledhje e rekomandimeve të KI në lidhje me çështjet e mësipërme dhe statusi i tyre aktual. Këto masa konkrete u përfshinë në ndryshimet ligjore në fund të vitit 2016 në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore*

në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Nga 37 masa lehtësuese të përfshira në ligj, 12 prej tyre lidheshin drejtpërdrejtë edhe me rekomandimet e miratuara në KI.

Gjithashtu në muajin tetor 2017 një paketë e re masash lehtësuese gjeti zbatim me Urdhërin nr. 101/1 datë 02.20.2017 në lidhje me kërkesat *për dokumente të shërbimeve të ofruara* ndaj biznesit dhe qytetarëve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucioneve në varësi të saj. Kjo ishte në vijim edhe të kërkesave të vazhdueshme nga komuniteti i biznesit (përfshirë KI) për uljen e burokracive dhe barrës administrative dhe informatizimin e proceseve dhe informacionit.

Gjithashtu, përmirësime të rëndësishme kanë pësuar edhe procedurat dhe afatet e lidhura me rimbursimin e TVSH-së në përgjithësi, veçanërisht ato që iu përkasin eksportuesve. Kështu, VKM nr. 460 datë 22.06.2016 ka sanksionuar afatet të qarta brenda të cilave administrata duhet të përmbushë detyrimin e saj ndaj bizneseve për rimbursimin e TVSH-së. Brenda 30 ditëve nga dita e kërkesës për tatimpaguesit eksportues, dhe brenda 60 ditëve për të gjithë tatimpaguesit e tjerë. Gjithashtu, në këtë akt u parashikua edhe rimbursimi automatik (pa kontroll/analizë risku) i TVSH-së për eksportuesit të cilët kanë vlerën e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursim, më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve. Këto ndryshime kanë çuar në një rritje të vlerës së rimbursimit të TVSH-së sipas Ministrisë së Financave² dhe të dhënave më të fundit të DPT. Sipas DPT për periudhën janar – tetor 2017 janë rimbursuar/kompensuar 554 nga 703

² Raporti i mes-vitit mbi zbatimin e buxhetit 2017 - vlerësimi i situatës makroekonomike, fiskale dhe buxhetore për 5-mujorin 2017, dhe pritshmëritë për 12-mujorin 2017, Ministria e Financave, Qershor 2017

kërkesa me vlerë 14,7 miliardë ALL dhe 161 kërkesa rimbursuar pa kontroll. Në raportin vjetor të DPT për 2016, raportohen 579 kërkesa të rimbursuara/kompensuara me vlerë 10,4 miliardë ALL dhe rimbursuar pa kontrolluar 97 kërkesa ose 15% të atyre të miratuara. Në totalin e shumës së rimbursuar/kompensuar gjatë vitit 2016, 68,2% e zë kategoria e eksportuesve dhe fasonistëve, 10,43% kërkesat për shkak të investimit.

Referuar të dhënave të publikuara tashmë nga DPT, përzgjedhja e kontrolleve bëhet sipas sistemit të riskut. Ka patur bashkëpunim të veçantë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në drejtim të analizave të indikatorëve të riskut, në funksioninim e kanalit jeshil ashtu dhe për përzgjedhjen e kontrolleve në rastet e regjimit të përpunimit aktiv.

Gjithashtu DPT ka analizuar performancën fiskale të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe ka nxjerrë sektorët më me risk për evazion, ku ndër prioritarët janë tregtia me pakicë, tregtia me shumicë, hotele dhe restorante, profesionet e lira, agrikultura dhe ndërtimet publike. Shërbimi i tatimpaguesit ka njohur zgjerim dhe ndërveprim dhe me institucione të tjera si QKB për informim mbi detyrimet fiskale të bizneseve

të reja. Sipas raportit vjetor 2016 të DPT, përveç shërbimeve standarde që kanë regjistruar një rritje në numër përsa i përket shkëmbimeve me tatimpaguesin, gjatë këtij viti është përmirësuar ky sistem nëpërmjet shërbimeve në *kohë reale* në rrugë elektronike, telefonike apo takime të drejtpërdrejta.

Me riorganizimin ligjor dhe institucional që pësuan falë ndryshimeve ligjore në fund të 2016, Drejtoria e Apelit Tatimor dhe Avokati i Tatimpaguesve konsiderohen se duhet te japin më shumë garanci për mbrojtjen e të drejtave të sipërmarrjes në fushën e procedurave tatimore. Programi i ri qeverisës ka marrë përsipër që nëpërmjet reformimit të institucioneve publike, të bëhet dhe një reduktim masiv i procedurave dhe dokumentave shtetërore për bizneset dhe qytetarët. Kjo reformë do të reduktojë më tej barrën administrative të bizneseve dhe do të rrisë efektivitetin e shkëmbimeve elektronike të informacionit nëpërmjet institucioneve publike. Sfidë mbeten kapacitetet administrative të institucioneve publike për t’iu përgjigjur realisht lehtësimeve procedurale të propozuara në raport me komunitetin e biznesit dhe më tej me qytetarin.

METODOLOGJIA E VROJTIMIT

Ky vërtetim i Sekretariatit u krye online, ku pyetësi u vendos në faqen e internetit të KI. Plotësimi i pyetësit u bë në mënyrë rastësore nga bizneset, të cilat janë anonime në vërtetim. Nëpërmjet regjistrimit të IP-ve të përgjigjeve u bë e mundur eliminimi i përgjigjeve të përsëritura. Nëpërmjet këtij vërtetimi është synuar të gjenerohen më tepër rezultate cilësore. Sekretariati nuk merr përsipër që gjetjet e vërtetimit të jenë përgjithësuese të popullatës së bizneseve në Shqipëri. Janë 146 kompani që janë përgjigjur elektronikisht vërtetimit, një rritje e konsiderueshme në krahasim me numrin e plotësimeve në vërtetimet e mëparshme online të Sekretariatit (2015 - 2016) Kjo rritje nënkupton një ndërgjegjësim të biznesit për të reaguar ndaj problematikave, por dhe një përdorim më i madh i komunikimeve elektronike. Bazuar në vërtetimet e kryera më parë, u synua të ndiqen të njëjtat hapa të përshkruara si më poshtë:

A. Faza Përgatitore

- » Rishikimi i pyetësorëve të përdorur në tre vërtetimet e mëparshme duke u fokusuar në pyetjet që i përgjigjen çështjeve që do të rivelesohen në këtë vërtetim.
- » Pyetësi është gjysëm i strukturuar me pyetje të mbyllura dhe të hapura me qëllim marrjen e sa më shumë të dhënave cilësore.
- » Pyetësi u konsultua me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe u testua me disa biznese.

B. Lançimi i Vërtetimit

- » Pyetësi qëndroi i publikuar online në faqen e internetit të KI gjatë 15 korrik – 15 shtator 2017.
- » Vërtetimi u publikua si lajm në faqen e KI dhe u shpërnda me email në adresat e regjistruara në faqe. Gjithashtu, njoftimi u publikua në rrjetet sociale si Facebook dhe Twitter.

- » Lista e Sekretariatit e kontakteve të biznesit e krijuar gjatë punës në bashkëpunim dhe me QKB, DPT, DPD, dhe shoqatat e biznesit, u përditësua me të dhëna nga Universiteti Epoka. Nëpërmjet bashkëpunimit me këtë të fundit u angazhuan një grup studentësh në kontaktimin e më shumë se 1.000 bizneseve me telefon për të nxitur plotësimin e pyetësit. Gjatë kontakteve telefonike u mundësua dhe përditësimi i adresave elektronike për bizneset.
- » Rreth 8.000 kontakteve të listës së bizneseve të Sekretariatit të përdorur dhe në anketat e mëparshme iu dërgua me e-mail linku i pyetësit.
- » Rikujtesë periodike me e-mail bizneseve për plotësimin e pyetësit.

C. Përpunimi i të dhënave

- » Në bashkëpunim me Universitetin Epoka u mundësia gjenerimi dhe përpunimi i të dhënave sasiore dhe cilësore. Gjithashtu nëpërmjet modeleve statistikore u testua dhe besueshmëria e rezultateve sasiore të gjetjeve dhe në veçanti në krahasimin e rezultateve me gjetjet e vërtetimeve të mëparshme.
- » Përpunimi i të dhënave u bë për rezultatet e *Vërtetimit 2017*, por në çështje të caktuara u synua dhe krahasimi me gjetjet e anketave të

mëparshme të Sekretariatit, sipas qëllimit të vërtetimit.

D. Konsultimi i gjetjeve

- » Rezultatet paraprake të përpunuara të vërtetimit u prezantuan në një takim konsultues me ekspertë fiskalë dhe përfaqësues të shoqatave të biznesit. Komentet dhe sugjerimet u konsideruan në ripunimin e gjetjeve të vërtetimit.
- » Rreth 5 takime u zhvilluan me biznese në Tiranë dhe rrethe për të konsoliduar gjetjet e vërtetimit.

E. Profili i bizneseve të përgjigjura në pyetësi

- » 146 biznese janë përgjigjur online pyetësit të Sekretariatit. Përgjigjet kanë qenë anonime dhe rastësore.
- » Sektori i shërbimeve zë vendin më të madh të bizneseve përfaqësuese në anketë në 47% të përgjigjeve, i ndjekur nga *tregtia, industria dhe ndërtimi*.
- » Biznesi me xhiro mbi 8 milion ALL është në shumicë i përfaqësuar në anketë në 78% të përgjigjeve, dhe biznesi me pronësi vendase në 74% të përgjigjeve.
- » 32% e të përgjigjurve deklarojnë se janë biznese eksportuese ku 54% e tyre janë eksportues mbi 70% të shitjeve.

GJETJET E VROJTIMIT

Gjetjet e vrojtimit janë përqendruar në dy drejtime. Së pari, në evidentimin e rezultateve për 2017 për të parë se ku konsistojnë problematikat aktuale të bizneseve, dhe së dyti, në krahasime me gjetjet e anketave të mëparshme në disa nga të dhënat sasiore të vrojtimit. Në pyetësor, një pjesë të konsiderueshme e zënë pyetjet e hapura për të marrë sa më shumë informacion përshkrues për analizë cilësore të gjetjeve. Ky informacion është përpunuar në një nivel të caktuar në të dhëna sasiore sipas disa çështjeve/shtyllave kryesore për të dhënë një paraqitje më të strukturuar të problematikave dhe sugjerimeve të biznesit. Sidoqoftë, rastet e përgjigjeve me artikulime konkrete të shqetësimit të biznesit janë ruajtur nga Sekretariati, për t'u konsideruar në vazhdim gjatë punës në analizat e mëtejshme të Këshillit të Investimeve. Gjetjet sipas shtyllave kryesore të qëllimit të vrojtimit janë:

1. MBI KONTROLLIN TATIMOR

Dinamika drejt ndryshimit të natyrës së kontrolleve, nga kontrolle të plota drejt inspektimeve në terren dhe vizitave fiskale.


Më konkretisht, nga përgjigjet e marra rezulton një rritje e lehtë e numrit të kontrolleve për 2016, dhe e disagreguar sipas llojit të kontrollit duket se rritja i dedikohet inspektimeve në terren dhe vizitave fiskale. Ndërkohë, në ndarjen e të dhënave sipas sektorëve, është më e dukshme rritja e inspektimeve tatimore tek sektori i tregtisë dhe shërbimeve. Të dhënat janë të pritshme po t'i referohemi dhe përpjekjeve të Qeverisë kundër informalitetit dhe rritjes së inspektimeve në terren kryesisht sipas vlerësimit të sistemit të riskut, ku tregtia dhe shërbimet janë vlerësuar me riskun më të lartë.

Përmirësimi i profesionalizmit të inspektorit tatimor, veçanërisht në drejtim të komunikimit, sjelljes dhe etikës ndaj biznesit. Në vrojtimit, profesionalizmi i inspektorit tatimor është parë në disa elementë si, sjellja/etika, komunikimi, kompetencat profesionale dhe mbështetja logjistike. Nga përgjigjet, ka një vlerësim mbizotërues "profesional" në agregatin e tërë elementëve. Kriteri që është vlerësuar më pak dhe është dallues si "jo profesional" mbetet "mbështetja logjistike". Sjellja/etika dhe komunikimi janë ndër elementët e profesionalizmit të vlerësuar më pozitivisht. Në krahasimin që është u bërë përgjigjeve të vrojtimit në 2017 me përgjigjet ndaj së njëjtës pyetje në vrojtimin e 2015 vihet re një përmirësim në vlerësimet e biznesit kundrejt profesionalizmit të inspektorit tatimor sidomos në lidhje me etikën dhe komunikimin. Akoma biznesi percepton se ka nevojë për investime dhe ngritje kapacitetesh profesionale të inspektorëve në administratën tatimore për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të tij. Theksojmë se rezultatet krahasimore me 2015 u testuan për besueshmërinë e tyre me metoda

statistikore ku *t-test* tregoi një nivel *significance* të kënaqshëm në 5%. Figura 1 jep një paraqitje krahasuese të mesatareve të përgjigjeve të perceptimit mbi inspektorin tatimor, raportin e kontrollit tatimor, qartësinë e shpjegimeve fiskale të administratës tatimore dhe kënaqësinë në shërbimet e-tax. Në tërësi ka një perceptim më pozitiv me përmirësim të të gjithë këtyre elementeve të vlerësuar mbi administratën tatimore (*1 është vlerësimi shumë profesional/shumë i qartë/shumë i kënaqur, dhe 5 është vlerësimi shumë jo profesional/shumë i paqartë/shumë i pakënaqur*).


Cilësia e raportit të kontrollit tatimor është një aspekt tjetër i përfshirë në vrojtimit. Në përgjithësi vihet re një tendencë vlerësimi e lartë në lidhje me "qartësinë" e raportit në të gjithë elementët e konsideruar. Vlerësimi në vrojtimin e fundit është në përmirësim kundrejt përgjigjeve ndaj së njëjtës pyetje në vrojtimin e 2015. Megjithatë ka akoma probleme të raportuara në veçanti tek "përmbytja e raportit" dhe "gjetjet/përfundimet" ku ka një numër më të lartë përgjigjesh në "shumë i paqartë" dhe "disi i qartë".

Figura 1. Mesatare e vlerësimit të perceptimit të bizneseve 2015 - 2017



Burimi: Përpunim i Sekretariatit nga të dhënat e vrojtimit

Figura 2. Sjellja/ Etika e Inspektorit Tatimor, 2015 – 2017




Burimi: Përpunim i Sekretariatit nga të dhënat e vërtetimit

2. MBI RIMBURSIMIN E TVSH-SË

Ndonëse ende ka problematika për respektimin e afateve, rezultojnë një trend në rritje të rasteve të rimbursimit në afat, veçanërisht brenda 30 ditëve për eksportuesit mbi 70%.

Ndër bizneset e përgjigjura rastësisht në vërtetim, rezultojnë se 22% (30 kompani) kanë aplikuar gjatë periudhës shtator 2015 – qershor 2017 për rimbursim TVSH-së. Teprica kreditore e krijuar për rimbursim është kryesisht prej aktivitetit të eksportit, por ka raste të raportuara (30% prej tyre) edhe prej investimeve të kryera. Gjatë 2016 ka patur zhvillime të rëndësishme në procedurat tatimore përsa i përket lehtësimit të procesit

Figura 3. Qartësia e Raportit të Kontrollit Tatimor, 2017



të rimbursimit sidomos për eksportuesit mbi 70%. Qëllimi i ndryshimeve ka qenë për të nxitur eksportet dhe lehtësuar likuiditetin në këtë kategori biznesesh. Në vërtetim 27 biznese (15 prej tyre eksportues mbi 70%) janë përgjigjur që e kanë marrë rimbursimin e TVSH-së të paktën një herë gjatë periudhës shtator 2015 – qershor 2017.

Rimbursimi automatik ka një rritje të numrit të rasteve të deklaruara në vërtetim, ku 10 biznese deklarojnë se janë rimbursuar automatikisht (5 raste të eksportuesve mbi 70%) kundrejt vërtimit të kryer në 2016 (ku u raportuan vetëm 2 raste). Shikohet një konsolidim drejt respektimit të afateve të rimbursimit ku 9 raste raportojnë rimbursim brenda 30 ditëve dhe 14 raste brenda 90 ditëve. Të dhëna nga DPT konfirmojnë një trend konsolidimi në rimbursimin automatik, sidoqoftë,


akoma ka nevojë për më *tepër* informacion veçanërisht nga eksportuesit për të konfirmuar respektimin e afateve. Sërisht, ndër ata që kanë marrë rimbursimin e TVSH-së janë deklaruar tejkalime afatesh edhe përtej 90 ditë edhe pse më pak se në anketën e 2016. Megjithatë, duhet thënë se në vërtetim, por dhe në takime direkte të Sekretariatit me bizneset ka ende reagime për kontrole të kryera pas rimbursimit automatik.

Rimbursimi i TVSH-së dhe impaktit të mundshëm në investime është konsideruar në vërtetim nëpërmjet pyetjes – “*A ndikon rimbursimi i TVSH-së në vendimin për të investuar?*” – duke bërë një seleksionim të përgjigjeve vetëm për eksportuesit. Sipas rezultateve duket se tek një pjesë e mirë e eksportuesve (40% në vërtetim) vlerësojnë se procesi i rimbursimit të TVSH-së

mund të ketë një efekt në vendimin e tyre për investime të mëtejshme. Megjithatë, jemi në një trend rënës kundrejt vërtimit të 2016, ku 60% u përgjigjën pro kësaj pyetje, ndaj sugjerohet një analizë më e thelluar në drejtim të efektit mbi investimet për këtë kategori.


Sugjerimet mbi lehtësimin e mëtejshëm të rimbursimit të TVSH-së kanë ardhur në vërtitim nga bizneset e përgjigjura, si: i) rimbursim automatik për eksportet dhe shkëmbim informacioni nga doganat kur kryhet eksporti; ii) kreditim automatik të tepicës kreditore të TVSH-së; iii) mundësia e sistemit të detyrimeve të tjera me gjendjen e kreditueshme të TVSH-së, si tatim fitimi, tatim mbi qeratë, dividendë apo penalitete, nga sistemi dhe pastaj risku të përcaktojë nëse duhet kontroll apo jo.

Figura 4. Afatet e rimbursimit të TVSh-së



Burimi: Përpunim i Sekretariatit nga të dhënat e vërtimit

Figura 5. A ndikon rimbursimi i TVSh-së në vendimin për të investuar?



3. MBI MARRËDHËNIET ME ADMINISTRATËN TATIMORE

Marrëdhëniet biznes - administratë tatimore rezultojnë në vitin 2017 me një përmirësim të nivelit të transparencës dhe komunikimit, në drejtim të raportit, aksesit në kohë dhe cilësisë së informacionit krahasuar me 2015.

Krijimi i kanaleve të qëndrueshme dhe të besueshme të komunikimit dhe ndërveprimit me administratën tatimore mbetet një faktor shumë i rëndësishëm për bizneset. Kjo për faktin se në vite ka patur një marrëdhënie të tensionuar mosbesimi ndërmjet të dy palëve e reflektuar si në raportet ndërkombëtare, komentet e shoqatave të biznesit apo edhe në takimet e drejtpërdrejta të Sekretariatit me bizneset.

Qartësia e informacionit të ofruar nga administrata tatimore - dy të tretat e përgjigjeve të bizneseve në vrojtim luhaten ndërmjet “i qartë” dhe “disi i qartë”. Vlerësohet se ka një përmirësim në reagimin dhe perceptimin e biznesit ndaj qartësisë së informacionit të ofruar nga administrata tatimore kundrejt përgjigjeve të marra në vrojtimin e 2015. Reformimi i shërbimit të tatimpaguesve, përmirësimi i faqes së internetit si edhe takimet informuese që janë ndërmarrë në vitin e fundit nga DPT mendohen si faktorë që mund të kenë ndikuar në përmirësimin e reagimit të bizneseve. Megjithatë, sërish bizneset ankohen se në shumë raste kur kërkohen sqarime konkrete për interpretime të caktuara, administrata tatimore vazhdon të bëjë vetëm citim të akteve ligjore pa orientuar qartë tatimpaguesin.

Informimi ndaj përzgjedhjes me sistem risku për kontroll duket se është në nivele shumë të kënaqshme, ku 67% përgjigjen se janë të informuar. Ka një rritje të konsiderueshme kundrejt vrojtimin në 2015 ku dijenia apo niveli i informimit mbi sistemin e riskut ishte shumë e ulët nga bizneset e përgjigjura (39%). Është i kuptueshëm ky përmirësim pasi sistemi i riskut është vënë në zbatim në fund të 2015 nga DPT dhe ka vazhduar të konsolidohet gjatë dy viteve në vazhdim me përditësimet e të dhënave dhe indikatorët e riskut. Bizneset duket se janë tashmë të ndërgjegjësuar se përzgjidhen për kontroll tatimor në bazë të treguesve të riskut të analizuar nga DPT.

Përfutuesit e trajnimeve të administratës mbeten ende në nivele të ulëta (afërsisht në 20% të përgjigjeve), dhe kryesisht përmenden trajnime mbi përdorimin e platformës e-tax. Trajnimi i taksapaguesve, megjithë përjekjet e AT, sipas bizneseve nuk është në fokus të punës së përditshme të DPT, por më shumë përjekje janë të nevojshme sidomos për taksapaguesit e vegjël dhe ata që do bëhen pjesë e sistemit të TVSH-së.

Kënaqësia nga shërbimet elektronike të ofruara nëpërmjet e-tax është në nivele shumë të larta. Mesatarisht 56% e bizneseve në vrojtim shprehen “të kënaqur” në të gjithë treguesit e vlerësuar si “aksesi në sistem” dhe “saktësia e përpunimit të të dhënave nga administrata tatimore”. Ka një përmirësim të dukshëm të kënaqësisë kundrejt vlerësimit në 2015. Rezultatet krahasimore u testuan për besueshmërinë e tyre me metoda statistikore ku t-test tregoi një nivel *significance* të kënaqshëm në 5%.

4. MBI INFORMALITETIN

Vërehet një perceptim në rënie “të lehtë” në lidhje me masën e fenomenit “informalitet” në krahasim me 2015, ndërkohë që pragu i tatim fitimit/TVSH-së, marrëdhënia me administratën dhe zbatueshmëria e ligjit, mbeten faktorët kryesorë që influencojnë informalitetin.

Konkurrenca e pandershme nga aktivitetet informale vazhdon të mbetet shqetësim i konsiderueshëm i biznesit edhe në vrojtimin e 2017. Një pjesë e mirë e të përgjigjurve (69%) shprehen se ndeshen me një formë të informalitetit në fushën e aktivitetit të tyre. Natyra e shfaqjes së informalitetit në sektorin ku operojnë është e ndryshme, por më të përmendurat në vrojtim janë evazoni fiskal për shkak dhe të korrupsionit dhe kontrabandës, puna në të zezë, moslëshimi i kuponit tatimor, etj. Do të theksonim si risi të vrojtimin në 2017, faktin që ka një dinamikë tjetër në shfaqjen e informalitetit në krahasim me vrojtimin e 2015, ku perceptimi i informalitetit në formën e “mosregjistrim” i biznesit ka rënë krahasuar me 2015. Ndërkohë, puna në të zezë vazhdon të jetë sërish problem dhe pothuajse në të njëjtin nivel perceptimi si në përgjigjet në vrojtimin e Sekretariatit në 2015. Një gjetje e vrojtimin, ardhur si shqetësim i ri, direkt nga bizneset është informaliteti në sektorin e turizmit, veçanërisht për guidat dhe agjencitë turistike.

Vërehet një konsolidim i ndërgjegjësimit të biznesit mbi të kuptuarit e kostove dhe përfitimeve të informalitetit, si gjetje dhe në vrojtimin e 2015. Përsëri një pjesë e mirë e bizneseve

në vrojtim shprehen se ka më shumë kosto se përfitim të qenit informal (figura 6). Megjithatë, ka patur përgjigje në vrojtim që e shikojnë të qenit informal përfitim në afat të shkurtër, por që mbart kosto për biznesin në afat të gjatë nëse do të zgjerohet më tej.

Të pyetur nëse kanë **strategji për t’u formalizuar**, në shumicë bizneset janë përgjigjur që nuk kanë informalitet në aktivitetin e tyre. Vërehet një mospërputhje nga përgjigjet e vetë bizneseve, ndërmjet perceptimit të lartë mbi informalitetin në sektorin e tyre (69% e përgjigjeve) dhe eksperiencës konkrete me informalitetin (74% deklarojnë se nuk kanë informalitet).

E njëjta marrëdhënie e zhdrejtë ndërmjet perceptimit dhe eksperiencës individuale në lidhje me informalitetin është konstatuar edhe nga përgjigjet e marra në vrojtimin e vitit 2015 ndaj të njëjtave pyetjeve.


Faktori fiskal më i rëndësishëm që mund të nxisë informalitetin tek bizneset ka qenë një pyetje me alternativa drejtuar bizneseve në vrojtim. Faktorët që krijojnë hapësira për informalitet dhe të vlerësuar si më të rëndësishmit nga biznesi janë: i) zbatimi i procedurave tatimore; ii) kapacitetet e administratës tatimore, iii) pragu i TVSH-së, dhe d) pragu i tatim fitimit. Nëse i konsiderojmë si shumatore dy të fundit në një faktor të vetëm, *fragmentizimi i sistemit tatimor* del si shkak i parë më i rëndësishëm i sjellë nga bizneset. Duhet theksuar se bizneset e përgjigjura në këtë vrojtim janë në shumicë mbi 8 milion ALL xhiro vjetore dhe kryesisht nga sektori i shërbimeve dhe tregtisë.

Në vrojtim është lënë hapësirë për përgjigje të hapura mbi disa çështje të lidhura me informalitetin me qëllim marrjen e sa më shumë reagimeve, komenteve dhe sugjerimeve nga bizneset mbi fenomenin në Shqipëri. Konkretisht, bizneset

janë pyetur mbi shkaqet që nxisin në tërësi informalitetin, incentivat për formalizim të ekonomisë dhe problematika të tjera që ndeshin gjatë të bërit biznes në vend.

Mbi shkaqet që nxisin informalitetin në sektorin ku operojnë një larmishmëri përgjigjesh kanë ardhur nëpërmjet vërtetimit. Sekretariati ka bërë një grupim të tyre sipas disa shtyllave që përgjithësojnë deri diku komentet e marra, që janë i) korrupsioni dhe ndikimi politik i bizneseve; ii) kapacitetet e administratës tatimore dhe doganore; iii)

Figura 6. A ndesheni me konkurrencën informale në sektorin tuaj?




Burimi: Përpunim i autorëve nga të dhënat e vërtetimit

Sugjerime konkrete mbi incentivat që mund të lehtësojnë formalizimin e ekonomisë - vihet re një ndryshim në qëndrimet e biznesit kundrejt incentivave të propozuara për formalizim në vërtetimin e 2015, ku theksohet partneriteti me biznesin, thjeshtimi i procedurave dhe rritja e

cilësia dhe qëndrueshmëria e legjislacionit fiskal; iv) konkurrenca e pandershme; v) fragmentizimi i sistemit tatimor; vi) taksat e larta; vii) niveli i ulët ekonomik. Numri më i madh i takon korrupsionit dhe ndikimit politik, pasuar nga kapacitetet e administratës tatimore dhe doganore si dhe legjislacioni fiskal. Nga përgjigjet në vërtetim ka dalë në pah dhe një faktor tjetër që nuk ka qenë artikuluar në vërtetimet e mëparshme të Sekretariatit që lidhet me kulturën e ulët fiskale të bizneseve. Në Shtojcën 3 janë bashkëlidhur dhe disa nga përgjigjet më të veçanta për pyetjet e hapura.

Figura 7. Kosto apo përfitim të qenit informal?



e kapaciteteve të administratës, etj. Për t'u theksuar, si përgjigje shumë e përmendur nga bizneset është kërkesa për bashkëbisedim dhe partneritet me administratën tatimore dhe qeverinë në tërësi mundësisht platforma sektoriale, incentivat për bizneset që investojnë, kontroll i tregjeve dhe ndërgjegjësim i konsumatorit final.

5. ÇËSHTJE TË TJERA MBI KLIMËN E INVESTIMEVE

Në interesin e vazhdueshëm të Sekretariatit është dhe thithja e mendimeve të bizneseve dhe për problematika të tjera që i shqetësojnë në lidhje me klimën e të bërit biznes në tërësi. Këto shqetësime konsiderohen më tej nga Sekretariati për të filluar diskutime mbi çështje të tjera në vazhdim për Këshillin e Investimeve. Sërish përgjigjet janë përpunuar në disa drejtime të evi-

dentuara edhe më parë si aspekte të veçanta të klimës së investimeve nga Sekretariati. Në vërtetimin e 2017 dalin si më problematike: i) burokracia administrative; ii) marrëdhëniet me administratën; iii) qartësia e legjislacionit fiskal; dhe iv) zbatimi i procedurave doganore. Ndërkohë, që në vërtetimin e 2016, përgjigjet e biznesit ndaj kësaj pyetje janë luhatur më shumë kundrejt: i) incentivat për investime; ii) marrëdhëniet me administratën; iii) qartësia e legjislacionit fiskal; iv) burokracitë administrative dhe iv) procedurat doganore. Disa nga këto çështje si incentivat për investime dhe procedurat doganore janë trajtuar edhe në mbledhjet e veçanta të KL.

Theksojmë, se ka një konsolidim në të dy vërtetimet e fundit në shqetësimet e biznesit për adresim të burokracive administrative, por dhe përmirësimit të profesionalizmit të administratës në marrëdhëniet me biznesin.

REKOMANDIME TË KI 2015-2016

Në dritën edhe të zhvillimeve të deritanishme, Sekretariati sugjeron se në lidhje me tematikat e trajtuara në vërtetim ka një sërë rekomandimesh të KI, të dhëna gjatë 2015 -2016, të cilat mbeten ende të pazbatuara apo janë zbatuar pjesërisht ndërkohë që problematikat mbeten ende aktuale. Më konkretisht:

REKOMANDIM 1.

Mbi Kontrollin Tatimor

1. Përcaktime ligjore mbi sistemin e riskut dhe publikimi indikatorëve. Përzgjedhje për kontroll deri në 90% nga sistemi i riskut (2015). Aktualisht janë publikuar nga DPT disa nga kriteret më kryesore të riskut por mbetet ende i paqartë sesa shkon *raporti i kontroleve që përzgjidhen nëpërmjet këtij sistemi*. Ndërkohë, mbetet sfidë dhe domosdoshmëri përditësimi i indikatorëve të riskut dhe analizave sektoriale të AT mbi bazën e gjetjeve nga kontrollet tatimore.
2. Të rritet mbështetja e AT me kapacitete njerëzore, buxhetore dhe logjistike. Caktimi i inspektorëve sipas specifikave sektoriale.

Paketa motivuese për inspektorët (2015). Ndonëse ka rritje të burimeve financiare të alokuara (2015-2017) në DPT, mbetet akoma sfidë për Qeverinë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonominë në kuadër të nevojave dhe kërkesave për modernizim të vazhdueshëm të shërbimeve fiskale ndaj tatimpaguesve. Ka nevojë për rritje të qëndrueshme të burimeve financiare për të mbështetur motivimin dhe profesionalizmin e punonjësve të administratës tatimore dhe besueshmërinë e tatimpaguesve.

3. Të programohen dhe publikohen programet vjetore të trajnimit të inspektorëve në bashkëpunim me shoqata biznesi, shoqëri konsulence dhe auditimi, mundësisht sipas sektorëve dhe nënsektorëve të caktuar.

Konstatohet një mendësi e re e administratës tatimore në komunikimin me biznesin e reflektuar si në gjetjet e vërtetimit edhe në Strategjinë e DPT-së dhe të dhënat e fundit të publikuara nga DPT mbi komunikimin me biznesin. Për një rritje të cilësisë dhe efikasitetit të komunikimit, do të sugjerohet të jetë sa i mëstrukturuar, mundësisht në grupe të vogla teknike për të adresuar problematika konkrete të bizneseve sipas sektorëve.

REKOMANDIM 2.

Mbi Rimbursimin e TVSH-së

1. Të synohet respektimi i afateve në rimbursim, sidomos për eksportuesit mbi 70%. Të bëhet transparente Rregullorja e Rimbursimit të TVSH-së.

Kuadri ligjor është konsoliduar dhe kompletuar bashkë me zbatimin e kanalit jeshil në dogana, si masë për nxitjen e eksporteve. Nuk është publikuar ende një Rregullore e Rimbursimit të TVSH-së. Mbetet ende për t'u përmirësuar përmbushja e afateve. Vendimmarrja në rimbursimin e TVSH-së mos të mbetet e kushtëzuar nga plani buxhetor i realizimit të të ardhurave i administratës tatimore.

REKOMANDIM 3.

Mbi Marrëdhëniet me Administratën Tatimore

1. Vendimet e DAT duhet të publikohen në mënyrë sistematike.
2. Informacion për tatimpaguesit që në momentin e regjistrimit në QKB. Publikimi i indikatorëve të riskut.
3. Të përgatiten manualë të thjeshtë mbi sistemin tatimor dhe sesione informuese kryesisht me biznesin e vogël dhe atë të mesëm.

Drejtorja e Apelit Tatimor referuar ndryshimeve më të fundit të ligjit "Mbi Procedurat Tatimore" ka filluar të funksionojë brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Megjithatë kërkohet që të rritet transparenca e veprimtarisë së DAT dhe vendimeve të marra prej saj.

Është përmirësuar shërbimi i tatimpaguesit në DPT dhe QKB, ndërkohë që ka mbështetje nga BERZH për krijimin e platformave informuese të tatimpaguesit pranë sporteleve të ADISA. Duhet të forcohet më tej roli i Avokatit të Tatimpaguesit, tashmë i transferuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ndërveprimi i mëtejshëm me bizneset. Roli i shoqatave dhe platformave të dialogut duhet të forcohet.

REKOMANDIM 4.

Mbi Informalitetin

1. Përgatitja dhe miratimi i një strategjie të mirëfilltë kundër ekonomisë informale.
2. Rivlerësim dhe analizë e sistemit fiskal aktual. Debati mbi prapën e TVSH-së, tatim-fitim, incentiva për formalizim.
3. Sistem rregullator i thjeshtë/lehtësim i barrës administrative. Rritja e aksesit në shërbimet e transaksionet bankare. Grante për bujqësinë.
4. Konsultim, transparencë dhe edukim. Vlerësim publik për bizneset e rregullta.

Informaliteti vazhdon të mbetet një nga shqetësimet kryesore të biznesit i ndjeshëm për ta në formën e konkurrencës së pandershme. Ka një ndërgjegjësim për nevojën për të reduktuar fenomenin në disa plane, ku ndër më kryesoret të përmendura nga bizneset mbeten:

- » Reduktimi i burokracive administrative dhe shkëmbimit më të shpejtë të informacionit ndërmjet institucioneve publike;
- » Qartësia e procedurave tatimore dhe doganore;
- » Rritja e kapaciteteve të administratës tatimore dhe doganore;
- » Bashkëbisedim, ndërveprim më aktiv dhe transparencë ndërmjet biznesit dhe administratës publike.

Bazuar në sa më lart, hapat e ndërmarra nga Qeveria mbi informalitetin si edhe diskutimi mbi uljen ose heqjen e pragut të TVSH-së për bizneset, me gjithë debatet publike mes ekspertëve pro dhe kundër, mendojmë se do të ketë një impakt real mbi informalitetin në vend. Ndërkohë kanë nisur disa nisma konkrete në kuadër të reformës derregullatore që synojnë të reduktojnë disa praktika të panevojshme dhe barrën administrative të biznesit për dokumentacion që është lehtësisht i gjenerueshëm nga brenda administratës publike nëpërmjet dixhitalizimit të mëtejshëm shërbimeve publike nga ana e institucioneve.

KONKLUSIONE

Vrojtimi i Sekretariatit mbi disa aspekte të klimës së investimeve sjell në vëmendje se megjithë përmirësimet e vërejtura në drejtim të natyrës së kontroleve tatimore, sjelljes dhe etikës së inspektorit tatimor, shërbimit të tatimpaguesit, etj., ka ende nevojë për një qasje më sistemike në drejtim të një partneriteti të qëndrueshëm me komunitetin e biznesit dhe në veçanti me bizneset e rregullta.

Shumë i rëndësishëm mbetet angazhimi drejt dixhitalizimit të mëtejshëm të shërbimeve publike ndaj biznesit dhe reduktimi i burokracive institucionale. Plani strategjik i DPT 2017-2021 ka përcaktuar qartë në objektivat e DPT-së ndër të tjera, reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik për përmbushje vullnetare të detyrimeve. Zbatimi i këtij plani do të ndihmojë në forcimin e besimit ndërmjet

administratës tatimore dhe komunitetit të biznesit si dhe qartësimin e mëtejshëm të rolit të administratës tatimore.

Ka një konsolidim drejt rimbursimit në kohë të TVSH-së kryesisht për eksportuesit, megjithatë duhet parë ecuria e rimbursimeve në total dhe sa i shkëputur do të jetë ky proces ndaj realizimit të planit të të ardhurave të DPT.

Konkurrenca informale mbetet shqetësimi i përhershëm i bizneseve dhe vlerësohen përpjekjet e fundit të qeverisë në drejtim të reduktimit të informalitetit. Marrëdhënia me administratën dhe zbatueshmëria e ligjit vlerësohen nga bizneset ndër faktorët kryesorë që influencojnë informalitetin. Ndërhyrje sistemike afatgjata kundër informalitet janë të nevojshme dhe është e domosdoshme të jenë të studiara dhe konsultuara me komunitetin e biznesit.

SHTOJCA 1

KOMENTE NGA BIZNESI

1. MBI RIMBURSIMIN E TVSH-SË

- » Rimbursim automatik për eksportet dhe shkëmbim informacioni nga doganat kur kryhet eksporti.
- » Kreditim automatik të tepricës kreditore të TVSH-së.
- » Mundësia e sistemimit të detyrimeve të tjera me gjendjen e kreditueshme të TVSH-së, si tatim fitimi, tatim mbi qeratë, dividendë apo penalitete nga sistemi dhe pastaj risku të përcaktojë nëse duhet kontroll apo jo.

2. FAKTORËT QË ÇOJNË NË INFORMALITET

- » Mungesa e zinxhirit të faturimit, blejmë shërbime që nuk janë objekt i TVSH-së dhe nuk i shkarkojmë dot TVSH-në në blerje, duke qenë se marrim fatura Model 4.
- » Informalitet në turizëm, tek guidat turistike dhe agjencitë e turizmit.

- » Mundësia për të fituar më shumë duke paguar më pak taksa. Fryma e përgjithshme në biznes dhe mungesa e kulturës së biznesi në përgjithësi.
- » Shtysë për konsumatorin final për të tërhequr kuponin tatimor.
- » Nuk ka kontrole ose janë të pamjaftueshme dhe sporadike, dhënia me lehtësi e licencave për veprimtari prodhuese. Nuk ka asnjë institucion që kërkon dhe kontrollon standartizimin e prodhimit dhe respektimin e normave teknike, ambientale, etj.
- » Heqja e të drejtës për shitje me pakicë (kupon) për biznesin e madh po krijon shoqëri fiktive të shitjes me pakicë, pasi biznesi i madh është i detyruar të krijojë këto shoqëri për të bërë të mundur shkarkimin e mallit që nuk pranon tregu i pakicës. Ky fenomen po bëhet modë dhe duhet gjetur një zgjidhje teknike për të eliminuar zinxhirin e shoqërive fiktive të pakicës.

3. INCENTIVA PËR FORMALIZIM

- » Rritja e bonuseve për doganierët nëse rrisin zhdoganimet e rregullta, kështu pjesën që marrin nën dorë do e marrin zyrtarisht bonus nga shteti.
- » Kërkesë të origjinës së produkteve në subjektet e tregtimit përfundimtar të produktit.
- » Ideja që një biznes që plotëson kriteret të certifikohet me një pullë dhe kështu inspektorët nuk mund të vijnë e të bëjnë presion çdo javë.
- » Mënyra më e mirë për të luftuar informalitetin është të kontrollohen dhe gjobiten qytetarët apo bizneset që nuk pranojnë t'iu japësh faturë me TVSH.
- » Mundësi sistemimi detyrimesh tatimore pa efekte të menjëherëshme penalitetesh nga kontrollet tatimore.
- » Ndërgjegjësim i publikut. Të merren incentiva që për çdo kupon tatimor do të rimbursohet 5 – 6 – 10 %.
- » Të gjitha subjektet që prodhojnë, shesin apo kanë aktivitet në fushën e agrobiznesit të jenë të pajisur me licencat përkatëse dhe të jenë objekt i monitorimeve sipas ligjit me qël-

lim që të jenë të gjithë të barabartë. Kjo sidomos është e theksuar nëpër rrethe.

- » Administrata tatimore të organizojë takime të veçanta sipas sektorëve ku t'i drejtojnë drejt formalizimit.
- » Një administratë tatimore e përgatitur—lë shumë për të dëshiruar niveli i militantizmit në administratën tatimore, të rinj e të vjetër nuk ka rëndësi, thjesht përzgjedhja është më shumë me baza lidhjesh partiake se sa me specializime profesionale. Të rinj sapo të diplomuar ose me maksimumi 1-2 vjet eksperiencë pune nuk mund të jenë kurrë pjesë e departamentit të kontrollit tatimor që shkojnë dhe kontrollojnë profesionistë që kanë vite në këtë fushë.
- » Shërbimi për tatimpaguesin më i hapur dhe në kontakt të drejtpërdrejt me profesionistët, të ndihmojnë subjektet që të raportojnë siç duhet detyrimet tatimore.
- » Informacioni sa më i aksesueshëm. Ligjet të dalin përpara se të zbatohen bashkë edhe me udhëzimet përkatëse dhe të mos ketë shumë ndryshime të ligjeve.

SHTOJCA 2 PYETËSORI

Ky pyetësor bazohet në anketat e kryera nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve në periudhën gusht 2015 – tetor 2016, mbi disa fusha të klimës së investimeve të konsideruara nga bizneset si më problematike. Çështjet që do mbulojë pyetësori në seksione të veçanta janë:

- » Kontrolli Tatimor;
- » Rimbursimi i TVSH-së
- » Informaliteti

Ky anketim vjen si propozim i anëtarëve të Këshillit të Investimeve, me synimin për të mundësuar një debat më të përditësuar mbi progresin e problematikave kryesore të biznesit gjatë 2015 – 2016. Qëllimi i anketimit është të bëjë një krahasim me gjetjet e anketimeve

të mëparshme mbi çështjet e mësipërme duke evidentuar problematika që vazhdojnë të jenë shqetësim i sektorit privat. Për më tepër, ofrohet mundësia nëpërmjet anketimit për të rekomanduar zgjidhje praktike kundrejt këtyre problematikave.

Gjetjet dhe sugjerimet e rezultuara nga ky pyetësor do të diskutohen në mbledhjet e ardhshme të Këshillit të Investimeve. Rekomandimet e miratuara nga Këshilli i Investimeve do t'i paraqiten Qeverisë Shqiptare për konsiderime të mëtejshme. *Kjo mund të sjellë ndryshime apo rishikime ligjore dhe rregullatore.*

Afati i plotësimit të pyetësorit është deri në datën **30 Shtator 2017.**

1. TË PËRGJITHSHME

1.

Aktiviteti kryesor ekonomik i biznesit tuaj është:

☐ Industri nxjerrëse

☐ Industri përpunuese

☐ Furnizim me energji elektrike, gaz e avull dhe me ajër të kondicionuar

☐ Aktivitete me ujë të ngrohtë, kanalizime, menaxhim të mbeturinave dhe rregullime

☐ Ndërtim

☐ Shërbim

☐ Tregti me shumicë dhe pakicë

☐ Transport dhe magazinim

☐ Hoteleri

☐ Informacion dhe Komunikacioni

☐ Aktivitete arkitekturore dhe inxhinierike

☐ Agjenci udhëtimi, operator turistik

☐ Të tjera (ju lutem specifikoni_____)
2.

Aksionerët më të mëdhenj (me mbi 50% të aksioneve) të biznesit tuaj janë:

☐ Vendas

☐ Të huaj
3.

Madhësia e biznesit tuaj sipas xhiros së vitit të fundit është:

☐ Deri në 5 milionë ALL

☐ 5 – 8 milionë ALL

☐ mbi 8 milionë ALL
4.

A jeni biznes eksportues?

Po____

Jo____

a. Nëse “po” specifikoni si më poshtë:

☐ Eksportues mbi 70% të shitjeve

☐ Eksportues nga 50% - 70% të shitjeve

☐ Eksportues më pak se 50% të shitjeve

2. MBI KONTROLLIN TATIMOR

5.

Seleksiononi natyrën dhe numrin e kontrollit tatimor në shoqërinë tuaj në secilin prej viteve të mëposhtme:

	Numri			
Lloji i kontrollit	2013	2014	2015	2016
☐ Kontroll i plotë tatimor				
☐ Vizitë fiskale				
☐ Inspektim në terren				
☐ Ri-kontroll				

6.

Përcaktoni kohëzgjatjen kohore të kontrollit/inspektimit të fundit tatimor:

☐ 1 javë

☐ 1 – 4 javë

☐ 1 – 3 muaj

☐ (specifikoni) _____

7.

Vlerësoni në vijim profesionalizmin e inspektorit tatimor në lidhje me:

Profesionalizmi i inspektorit tatimor	Shumë profesional	Profesional	Disi profesional	Jo profesional	Shumë jo profesional
Sjellja/Etika					
Komunikimi					
Kompetencat profesionale					
Mbështetja logjistike					

8.

Vlerësoni në vijim qartësinë e raportit të kontrollit tatimor të lëshuar nga inspektori në fund të kontrollit tatimor në lidhje me:

Qartësia e Raportit të Kontrollit Tatimor	Shumë i qartë	I qartë	Disi i qartë	I paqartë	Shumë i paqartë
Përmbajtja					
Formati					
Referencat					
Gjetjet/përfundimet					

3. MBI RIMBURSIMIN E TVSH-SË (PËR KOMPANITË QË JANË SUBJEKT I RIMBURSIMIT TË TVSH-SË)

9. A keni aplikuar për rimbursim TVSH në periudhën Shtator 2015 – Qershor 2017?
- ☐ Po
 - ☐ Jo

A. Nëse “po”, përgjigjuni në vazhdim. Nëse “jo”, kaloni tek seksioni B më poshtë pyetja 15.

10. Objekti i rimbursimit të TVSH-së lidhet me:
- b. Eksport
 - c. Investim
 - d. Tjetër_____
11. A keni përfituar rimbursimin e TVSH-së:
- ☐ Po
 - ☐ Jo
 - ☐ Në proces (lutem specifikoni sa kohë ka kaluar nga aplikimi, a jeni në proces kontrolli, jeni në proces disbursimi, etj.) _____

12. Nëse “po”, keni përfituar:
- ☐ Automatikisht nga sistemi;
 - ☐ Pas përfundimit të kontrollit tatimor përkatës;
 - ☐ Pas ankimimit tuaj (në Drejtorinë e Apelimit apo Gjykatë)
 - ☐ Tjetër _____
13. Nëse “po”, afatet e rimbursimit kanë qenë
- ☐ Brenda 30 ditëve
 - ☐ 30 – 60 ditë
 - ☐ 60 – 90 ditë
 - ☐ Mbi 90 ditë, specifikoni _____

14. Nëse nuk keni përfituar, mund të përmendni deri në tri arsye përse nuk jeni rimbursuar:
- _____
 - _____
 - _____

B. Nëse “jo”,

15. Përse nuk keni aplikuar:
- ☐ Procedura e komplikuar në sistem
 - ☐ Shumë dokumenta
 - ☐ Mungesë kapacitetesh tuaja për t’iu përgjigjur kërkesave të administratës tatimore
 - ☐ Për të mos iu nënshtruar kontrollit tatimor
 - ☐ Mungesë besimi për përfitimin e rimbursimit
 - ☐ Tjetër_____
16. Çfarë komentesh, sugjerime konkrete mund të keni për përmirësimin e procedurës së rimbursimit të TVSH-së, lutem specifikoni _____

17. A ka ndikuar procesi i rimbursimit të TVSH-së në vendimin tuaj për të investuar dhe përse:
- ☐ Po _____

 - ☐ Jo _____

4. MBI INFORMIMIN DHE KOMUNIKIMIN ME ADMINISTRATËN TATIMORE

18. Vlerësoni në vijim qartësinë e informacionit të ofruar nga Administrata Tatimore në lidhje me kuadrin ligjor tatimor.

Shumë i qartë	I qartë	Disi i qartë	I paqartë	Shumë i paqartë

19. A jeni në dijeni të faktit se përzgjedhja e tatimpaguesve për t’u inspektuar tashmë bëhet sipas sistemit të ri të bazuar në risk?
- ☐ Po
 - ☐ Jo

20. A keni marrë pjesë në sesione trajnimi të ofruara gjatë viteve të fundit nga administrata tatimore mbi zbatimin e legjislacionit tatimor?

☐ Po

☐ Jo

Nëse po, ju lutem jepni më poshtë sa më shumë detaje: _____

21. Vlerësoni në vijim kënaqësinë me shërbimet elektronike të tatimeve në lidhje me:

Tatimet elektronike	Shumë i kënaqur	I kënaqur	Disi i kënaqur	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Aksesi në plotësimin elektronik					
Besueshmëria e të dhënave					
Saktësia e përpunimit të të dhënave					

22. Rendisni tre faktorët më të rëndësishëm në lidhje me sistemin tatimor të taksave që mund t’iu detyrojë të ndërmerrni riskun e një aktiviteti informal (1. Më i rëndësishmi - 3. I rëndësishëm):

☐ Zbatimi i legjislacioni tatimor në përgjithësi

☐ Pragu i TVSH-së

☐ Pragu i tatim fitimit

☐ Kontrolli tatimor

☐ Marrëdhëniet me administratën tatimore

☐ Tjetër _____

5. MBI INFORMALITETIN

23. Lutem përcaktoni nëse vazhdoni të ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni?

☐ Po

☐ Jo

Nëse “po”, jepni komentet tuaja çfarë natyre ka informaliteti në sektorin tuaj (shmangie taksash, mosregjistrim, korrupsion, kontrabandë, punë në të zezë, etj.) _____

24. Lutem jepni mendimin tuaj mbi shkaqet që nxisin informalitetin në sektorin ku jeni:

25. Në këndvështrimin tuaj a ka më shumë përfitim apo kosto të qenit informal në sektorin tuaj dhe nëse mund të artikulonit më në detaje:

26. Nëse keni disi informalitet në biznesin tuaj a keni strategji për t’u formalizuar në afat të gjatë?

☐ Po

☐ Jo

☐ Nuk kam informalitet

27. Nga pikëpamja juaj, cilat mund të jenë disa incentiva të efektshme për të reduktuar informalitetin në sektorin tuaj?

28. Lutemi të jepni koment tjetër apo sugjerime mbi problematika të ndeshura për administrimin fiskal dhe klimën e investimeve për t’u konsideruar në vijim gjatë punës së Këshillit të Investimeve

FALEMINDERIT!

Për çdo paqartësi lutemi të na kontaktoni në: info@investment.com.al.

SHTOJCA 3

STATUSI I REKOMANDIMEVE

Më poshtë jepen 12 masat/ rekomandimet konkrete me natyrë ligjore, të përfshira në lehtësimet e procedurave [37 të tilla] të kryera me ndryshimet përkatëse në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (të ndryshuar) dhe legjislacionin sekondar përkatës.

1. REKOMANDIMI I KI:

Rritje e transparencës për treguesit kryesorë të riskut të përdorur nga sistemi elektronik i riskut për të identifikuar bizneset me risk dhe që rrjedhimisht janë objekt kontrolli.

Masa e ndërmarrë:

Plani Vjetor Administrativ i Menaxhimit të Riskut të Pajtuashmërisë 2016, fq 12-14.

2. REKOMANDIMI I KI:

Njoftimi paraprak i tatimpaguesve për kryerjen e kontrollit tatimor. Legjislacioni duhet të

parashikojë një afat kohor prej minimalisht 10 ditësh kalendarike për të njoftuar paraprakisht tatimpaguesin në rastet e kontrolleve të plota tatimore (me përjashtim të rasteve të kontrolleve në terren, të cilat mund të kryhen pa bërë ndonjë njoftim apo paralajmërim paraprak.

Masa e ndërmarrë:

Adresuar plotësisht madje me një standard më të lartë se ai i rekomanduar, nga 10 ditë në 30 ditë afati për njoftimin paraprak të kontrollit të plotë tatimor. Neni 81 i Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 dhe Udhëzimi nr. 24 i MF.

3. REKOMANDIMI I KI:

Njoftimi për kontroll tatimor i dërguar tatimpaguesit duhet të jetë më i detajuar.

Masa e ndërmarrë

Adresuar pjesërisht nga Ligji - në njoftimin e kontrollit do të parashikohet dhe afati i përfundimit të kontrollit, data dhe ora e saj. Ligji Nr. 9920 datë 19.05.2008 dhe Udhëzimi Nr. 24 i MF.

4. REKOMANDIMI I KI:

E drejta e ankimit efektiv për tatimpaguesit - garantimi i pavarësisë së DAT - ndryshime strukturore të apelimit tatimor.

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008; VKM Nr. 11 datë 11.01.2017 dhe Udhëzimi Nr. 24 i MF.

5. REKOMANDIMI I KI:

Krijimi i një organi kolegial apelimi në vend të DAT me ligj të veçantë, në trajtën e një "quasi gjykate" në kuadër edhe të planeve për bashkimin e administratës tatimore dhe administratës doganore për të shqyrtuar ankimet administrative (duke filluar nga një shumë e caktuar)

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008; VKM Nr. 11 datë 11.01.2017 dhe Udhëzimi Nr. 24 i MF.

6. REKOMANDIMI I KI:

Shfuqizimi i paragrafit 3, nenit 109, në Ligjin nr. 9920/2018. Vendimet e Drejtorisë së Apelit Tatimor (DAT), në cilësinë e njësisë më të lartë administrative për të marrë vendime mbi rastet e apelimit, duhet të jenë automatikisht detyruese për Drejtoritë Rajonale Tatimore (DRT).

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime Ligji Nr. 9920 datë 19.05.2008, Udhëzimi Nr. 24 i MF dhe VKM Nr. 11 datë 11.01.2017.

7. REKOMANDIMI I KI:

Vendimet e Apelit Tatimor nuk duhet të jenë objekt i apelimit të mëtejshëm në Gjykatën Administrative nga DRT.

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime Ligji Nr. 9920 datë 19.05.2008, Udhëzimi Nr. 24 i MF dhe VKM Nr. 11 datë 11.01.2017.

8. REKOMANDIMI I KI:

Forcimi i rolit të Avokatit të Tatimpaguesve

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime në pozicionimin e AT në raport me Administratën Tatimore - VKM, Nr. 10, datë 11.01.2017.

9. REKOMANDIMI I KI:

DPT-jadhe DAT-jaduhettëmarrin në konsideratë rritjen e kapaciteteve për analiza ligjore dhe për njësimin e praktikave të tyre, si dhe të pasqyrojnë vendimet përfundimtare të gjykatave për raste të ngjashme. Unifikimi i interpretimeve nga administrata tatimore - precedenti tatimor

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008, Neni 10 dhe Neni 28 paragrafi 3;

10. REKOMANDIMI I KI:

DPT-ja duhet të përgatisë dhe të publikojë Komentarin Vjetor të Rasteve në faqen e saj zyrtare të internetit.

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008, Neni 10 paragrafi 3 dhe Neni 28 paragrafi 1.

11. REKOMANDIMI I KI:

Ndryshimi i përcaktimeve ligjore lidhur me afatet e pagimit të tatimit mbi fitimin dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008, Neni 114/1.

12. REKOMANDIMI I KI:

Miratimi i projektligjit "Mbi Falimentimin" - Fillimi i procedurës së falimentimit në gjykatë nga administrata tatimore bëhet në përputhje me ligjin për falimentimin jo nga tatimet.

Masa e ndërmarrë:

Ndryshime në Ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008, Neni 104.

Më poshtë gjenden edhe disa nga rekomandimet e përmbushura përgjatë 2017 nga administrata tatimore dhe MF.

13. REKOMANDIMI I KI:

Rritja e transparencës së administratës tatimore
Masa e ndërmarrë:

- Publikimi i raportit të detajuar të DPT për 2016;
- Publikimi i manualeve mbi deklarimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe deklarimin e tyre elektronik;
- Njoftime periodike për tatimpaguesit në e-Tax dhe Media.

14. REKOMANDIMI I KI:

Informatizim (e-filing, deklarata online, shkëmbim informacioni, etj.) i sistemeve midis institucioneve të Administratës dhe shkëmbim online të informacionit, si p.sh. Tatime, Dogana, ZVRPP, Drejtoritë e Transportit, etj.

Masa e ndërmarrë:

Urdhër i MF Nr.101/1 datë 02.10.2017 “Për Lehtësimin e Kërkesave Dokumentare të Shërbimeve të Ofruara ndaj Biznesit dhe Qytetarëve nga Ministria e Fianancave dhe Ekonomisë dhe Institucioneve në Varësi të Saj”

15. REKOMANDIMI I KI:

Treguesit e përdorur të analizës së riskut duhet të përshtaten dhe të rregullohen sipas industrisë (turizmi, shërbimet, sektori bankar, sektori i tekstileve, etj.) dhe madhësisë së biznesit. Ndërkohë, është e qartë se formula e përdorur nga sistemi për përzgjedhjen e tyre duhet të mbetet rreptësisht e fshehtë.

Masa e ndërmarrë:

Publikimi i pjesshëm i disa prej tyre.

16. REKOMANDIMI I KI:

Inspektorët tatimorë duhet të caktohen në bazë të profilit të tatimpaguesit (tatimpagues të vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj) dhe në bazë të specifikave sektoriale.

Masa e ndërmarrë:

Ristrukturimi i organigramës së DPT.

17. REKOMANDIMI I KI:

Ofrimi i incentivave të prekshme për investitorët dhe bizneset. (Miratuar me VKM nr. 579 datë 03.08.2016 Udhërrëfyti i Politikës së Investimeve - Objektivi deri në shkurt 2018 hartimi i ligjit të unifikuar për investimet i cili do të ketë edhe listën e incentivave për bizneset, vendase apo të huaja.)

Masa e ndërmarrë:

Draft Ligji i Ri “Për Investimet e Huaja” në diskutim. Paketa fiskale 2018 në diskutim në komisionet e Kuvendit të Shqipërisë.

Më poshtë gjenden të listuara disa nga rekomandimet e diskutuara në KI dhe të cilat janë diskutuar gjerësisht, por për të cilat nuk ka patur hapa konkretë.

1. Qeveria duhet të garantojë një sistem krejtësisht transparent të kontrollit tatimor duke publikuar treguesit kryesorë të riskut që përdoren nga sistemi elektronik i riskut për të identifikuar bizneset me risk dhe që rrjedhimisht janë objekt kontrolli.
2. Planifikimi dhe miratimi duhet të jetë në nivelin më të lartë prej 90% të sistemit elektronik të riskut, për të gjitha llojet e kontrolleve, dhe jo vetëm për rimbursimin e TVSH-së. Për përzgjedhjen automatike, sistemi elektronik

i riskut duhet të mos fokusohet vetëm tek TVSH-ja, por edhe tek llojet e tjera të taksave (p.sh. tatimi mbi të ardhurat dhe tatimi mbi fitimin).

3. Kufiri për transaksionet me para në dorë për efekt të skemës së kompensimit të TVSH-së për fermerët mbetet ende objekt diskutimi dhe debati midis aktorëve, institucioneve dhe sektorit privat.
4. Unifikimi i strukturave të hetimit dhe kontrollit të administratës tatimore dhe doganore.
5. Organizimi i programeve të trajnimit të përbashkëta midis bizneseve dhe administratës do të parandalonin mosmarrëveshjet midis palëve. Njëkohësisht sugjerohen edhe trajnime të vazhdueshme dhe të përbashkëta midis Gjykatave Administrative, Adminis-

tratës Tatimore dhe Doganore nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës me ndihmën edhe të shoqatave të biznesit si p.sh. Shoqata Shqiptare e Bankave. Kjo do të ndihmonte edhe në unifikimin e praktikave si për administratën ashtu edhe për Gjyqësorin. Të parashikohen në programet vjetore të punës së Shkollës së Magjistraturës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave. *(Diskutime të përbashkëta në vazhdimësi Biznes-Inspektoriat Qendror-DPT).*

6. Avokatura e Shtetit, nëpërmjet rolit të saj aktiv me interpretime për çështje ligjore me karakter përgjithësues për të gjithë administratën publike. Për këtë janë të nevojshme edhe ndryshime ligjore në Ligjin nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”.

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council